URDHËR
Nr. 7375, datë 24.11.2015

MBI PROCEDURËN E PRANIMIT TË KANDIDATËVE PËR PUNONJËS NË POLICINË E BURGJEVE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë" dhe në ligjin nr. 10032, datë 11.12.2008, "Për Policinë e Burgjeve", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Pranimi i kandidatëve për punonjës në Policinë e Burgjeve, bëhet nëpërmjet procesit të hapur të konkurrimit, përzgjedhjes së drejtë e të paanshme.

2. Brenda datës 31 janar të çdo viti, Sektori i Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve planifikon numrin e vendeve të lira që krijohen për punonjës të Policisë së Burgjeve, mbështetur në numrin e punonjësve të liruar dhe të larguar nga Policia e Burgjeve të vitit paraardhës, si dhe vendet e lira që krijohen për shkak të ndryshimeve strukturore.

3. Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Sektori i Teknologjisë dhe Informacionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, shpallin procedurën e pranimit, duke publikuar në:

a) Faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve;

b) Në median e shkruar;

c) Në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit".

Njoftimi qëndron i publikuar deri në përfundimin e procedurës së pranimit.

4. Shpallja në faqen zyrtare të DPB-së përmban këto të dhëna:

a) Fushën kryesore mbi të cilën do të bazohet konkurrimi, si dhe aftësitë dhe cilësitë që do të vlerësohen në konkurrim;

b) Fazat në të cilat do të kalojë konkurrimi, me shkrim dhe me gojë;

c) Numrin e vendeve të planifikuara për të cilat do të bëhet pranimi;

ç) Kërkesat e përgjithshme, në përputhje me nenin 17, të ligjit nr. 10032, datë 11.12.2008, "Për Policinë e Burgjeve", të ndryshuar;

d) Përshkrimin e përgjithshëm të punës, për të cilën do të zhvillohet konkurrimi;

e) Kërkesat e veçanta që duhet të plotësojë kandidati për pozicionin përkatës;

ë) Dokumentet që duhet të dorëzohen dhe mënyrën e dorëzimit të tyre;

f) Afatin e dorëzimit të përcaktuar me datë të saktë kalendarike;

g) Datën e daljes së rezultateve për fazën e vlerësimit paraprak të kandidatëve;

h) Mënyrën e vlerësimit të kandidatëve në fazën e verifikimit paraprak, si dhe në fazën e vlerësimit të kandidatëve;

i) Mënyrën e njoftimit dhe të komunikimit me kandidatët.

5. Çdo person që konkurron për t'u pranuar si punonjës policie duhet të paraqesë, brenda afatit të njoftuar në shpallje, dokumentet e mëposhtme:

a) Formularin e plotësuar të aplikimit;

b) Fotokopje të pasaportës ose të kartës së identitetit;

c) Kopje të diplomës së shkollës së mesme/lartë;

ç) Formularin e vetëdeklarimit mbi gjendjen gjyqësore;

d) Vërtetim të lëshuar nga Prokuroria dhe Gjykata se nuk është në procedim penal;

e) Raport mjekoligjor që është i aftë për punë.

6. Dokumentacioni duhet të dorëzohet, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes, sipas përcaktimit në shpalljen për konkurrim.

7.1 Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e shpalljes së konkurrimit, kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe plotësojnë formularin e aplikimit.

7.2 Me marrjen e formularit të plotësuar dhe të dokumentacionit, Sektori i Burimeve Njerëzore krijon dosjen me numrin që merr kandidati.

8. Konkurrimi zhvillohet në dy faza:

a) Verifikimi paraprak, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe ato të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim;

b) Vlerësimi i kandidatëve.

9. Sektori i Burimeve Njerëzore, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimit të tyre, bën verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

10. Në përfundim të verifikimit, kandidatët, të cilët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të pozicionit të punës, renditen në një listë sipas rendit alfabetik. Kjo listë administrohet nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe shpallet në:

a) Faqen zyrtare të DPB-së;

b) Në median e shkruar; dhe

c) Portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", për administratën shtetërore.

11. Kandidatët që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuar në shpalljen për konkurrim, renditen në një listë të veçantë, në të cilën tregohen edhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kërkesave. Lista administrohet nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe nuk bëhet publike. Kandidatët që nuk janë kualifikuar njoftohen individualisht nga njësia përgjegjëse.

12. Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual, kandidatët që nuk janë kualifikuar kanë të drejtë të paraqesin ankesë me shkrim pranë drejtorit të Policisë së Burgjeve, i cili shprehet me shkrim brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së ankimit. Nëse ankimi pranohet, kandidati vazhdon konkurrimin.

13. Vlerësimi i kandidatëve përfshin:

a) Testin me shkrim;

b) Testin e aftësive fizike;

c) Kontrollin psiko-social;

ç) Intervistën me gojë.

14. Procedura e testimit, me përjashtim të testit të aftësive fizike dhe kontrollit psiko-social, kryhet nga Komisioni i Përhershëm i Testimit, i ngritur nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve. Komisioni përbëhet nga:

a) Tre përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë;

b) Dy përfaqësues nga DPB-ja, ku një përfaqësues është nga strukturat e Policisë së Burgjeve dhe një nga Sektori i Trajnimeve në Drejtorinë e Përgjithshme e Burgjeve.

15. Sektori i Burimeve Njerëzore njofton Komisionin, sipas pikës 14 të këtij urdhri, për datën e zhvillimit të vlerësimit të kandidatëve dhe për listën e kandidatëve. Komisioni merr vendime në praninë e të gjithë anëtarëve të tij.

16. Për çështje procedure, vendimet merren me votim nominal. Për vlerësimin e rezultateve për secilin kandidat, secili prej anëtarëve jep pikët e tij. Në përfundim, pikët e grumbulluara për secilën fazë mblidhen. Rezultati përbën edhe vlerësimin përfundimtar të kandidatit.

17. Përpara zhvillimit të vlerësimit me shkrim, testet e kandidatëve pjesëmarrës sekretohen, sipas mënyrës së përcaktuar nga Sektori i Burimeve Njerëzore.

18. Testi me shkrim kryhet brenda 15 ditëve nga data e përfundimit të shqyrtimit paraprak dhe shërben për të vlerësuar nëse konkurrenti zotëron njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për kryerjen e detyrave të punonjësit të policisë.

19. Rezultatet e testit me shkrim dalin brenda ditës së testimit. Kandidati që ka marrë mbi 60% të pikëve të përcaktuara për testin me shkrim, njoftohet për të vazhduar konkurrimin. Rezultatet e testit me shkrim ruhen në dosjen e kandidatit dhe përbëjnë 50% të rezultatit të përgjithshëm të tij.

20. Në përfundim të testit me shkrim, Komisioni publikon zyrtarisht listën me rezultatet e testimit në rend zbritës, në ambientet e dukshme të DPB-së dhe në faqen zyrtare të saj.

21. Nëse është e nevojshme, me urdhër të drejtorit të Policisë së Burgjeve mund të caktohen pranë Komisionit një ose më shumë nëpunës të organikës së tij për të kryer veprimtarinë e mbështetjes teknike dhe të sekretariatit. Këta, së bashku me Sektorin e Burimeve Njerëzore, kryejnë detyrat e mëposhtme:

a) Në hyrje të ambientit ku zhvillohet testimi, afishon listat e kandidatëve të pranuar për konkurrim;

b) Para fillimit të regjistrimit, kandidatët qëndrojnë jashtë dhe futen me radhë, sipas orientimeve që jepen;

c) Në hollin e ambientit ku zhvillohet testimi, vendosen grupet e regjistrimit që regjistrojnë kandidatët;

d) Kandidati duhet të paraqitet me kartën e identitetit në testin me shkrim dhe pasi të verifikohet nga ana e regjistruesve, bëhet regjistrimi i tij;

e) Pas regjistrimit, kandidatit i jepet fleta e testit;

f) Në këtë rast kandidati nënshkruan në listën që kanë regjistruesit, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tij;

g) Kandidatët orientohen të hyjnë në sallë nga punonjësit e caktuar me shërbim për këtë qëllim;

h) Në sallë nuk lejohet të hyjë asnjë person tjetër, përveç kandidatëve;

i) Në sallë ku persona orientues, që drejtojnë kandidatët ku duhet të ulen;

j) Me të përfunduar regjistrimi, nuk lejohet hyrja e askujt në sallë, mbyllet salla dhe fillon dhënia e udhëzimeve;

k) Kandidatëve u shpërndahen testet dhe nuk kryejnë asnjë veprim me to, deri sa të fillojë koha për të gjithë njëkohësisht;

l) Kandidatëve u komunikohet koha që kanë në dispozicion për kryerjen e testimit;

m) Ndihmojnë në shpërndarjen e testit;

n) Monitorojnë pozicionin që u caktohet në sallën ku zhvillohet testimi;

o) Monitorojnë kandidatët që të mos kopjojnë ose të flasin me njëri-tjetrin, të mos përdorin celularët, makinat llogaritëse apo mjet tjetër, përveç atyre që u jepen;

p) Kur konstatojnë që kandidatët shkelin rregullat, kontaktojnë me përgjegjësin e grupit të mbikëqyrësve që të marrë masa e t'i largojë menjëherë nga testimi;

q) Në qoftë se ndonjë nga kandidatët mbaron testin dhe mbledhin të gjitha materialet dhe i dorëzojnë te Komisioni;

r) Kandidatët që mbarojnë më herët se koha në dispozicion, kanë të drejtë të dalin jashtë dhe të kthehen përsëri në sallë, pasi të kenë përfunduar të gjithë kandidatët e tjerë;

s) Kandidati që kërkon të dalë nga salla ku zhvillohet testimi për nevoja personale, largohet pa marrë gjë me vete dhe një person e shoqëron atë deri në kthimin e tij në sallë;

t) Njoftojnë kandidatët disa herë për kohën e mbetur në dispozicion;

u) Mbledhin testet dhe bazën materiale në përfundim të orarit dhe sistemohen në vendin e caktuar.

22. Në përfundim të testimit me shkrim, nëse disa pyetjeve të testit u përgjigjen saktë më pak se 10% e kandidatëve pjesëmarrës, pavarësisht përgjigjeve që mund të jenë dhënë nga kandidatë të veçantë, këto pyetje konsiderohen të pavlefshme. Pikët për këto pyetje u jepen automatikisht të gjithë kandidatëve.

Pas përfundimit të procesit pyetjet e konsideruara të pavlefshme duhet të analizohen. Nëse pyetjet nuk kanë qenë të formuluara mirë apo përgjigjet kanë qenë të gabuara, ato përmirësohen për t'u përdorur në procese të tjera të testimit, në të kundërt, hiqen dhe nuk përdoren.

23. Kandidatët që kalojnë testin me shkrim, i nënshtrohen testit të aftësive fizike, ku përfshihen:

a) Shpejtësia;

b) Shkathtësia fizike;

c) Rezistenca;

d) Forca muskulore;

e) Koordinimi fizik.

24. Drejtori i Policisë së Burgjeve ngre me urdhër komisionin për përcaktimin e standardeve të testit për aftësitë fizike. Testi i aftësive fizike vlerësohet sipas standardit të përcaktuar në kohën e zhvillimit të testit.

25. Kriteret për kalimin e testit të aftësive fizike, janë:

a) Përfundimi i të gjitha ushtrimeve brenda kohës së caktuar;

b) Kalimi i të gjitha fazave në rendin e kërkuar.

26. Anëtarët e Komisionit të testit fizik u japin udhëzime kandidatëve për të gjithë komponentët, duke i demonstruar me veprime konkrete dhe kryejnë detyrat e mëposhtme:

a) Sigurohen që kandidati i kupton veprimet që duhet të kryejë;

b) Vëzhgojnë kandidatin gjatë gjithë testit;

c) Shënojnë të gjitha pikët në fletën e testit për çdo kandidat, për secilën garë;

d) Shënojnë në fletën e testit për kandidatin "kalon/ngel" dhe e dorëzojnë fletën e testit te personat që kryejnë regjistrimin.

27. Pas përfundimit të testit fizik, kandidati njoftohet për rezultatin dhe nëse ka fituar, njoftohet për të vazhduar fazat e tjera të vlerësimit. Rezultatet e testit fizik ruhen në dosjen e kandidatit.

28. Kandidatët e përzgjedhur i nënshtrohen më pas kontrollit psiko-social, që organizohet nga Sektori i

Çështjeve Shoqërore dhe Sektori i Çështjeve Shëndetësore të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, për të përcaktuar përshtatshmërinë e tyre nga pikëpamja psiko-sociale për të kryer detyrat si punonjës i Policisë së Burgjeve. Në këtë kontroll vlerësohet:

a) Personaliteti i kandidatit;

b) Nëse ka deklaruar të dhëna të rreme apo ka paraqitur dokumente të falsifikuara, që kanë për qëllim të rrisin mundësitë për punësim të kandidatit;

c) Nëse ka prirje që tregojnë se kandidati paragjykon, diskriminon për arsye të etnisë, gjinisë, moshës, prirjes seksuale, racës, fesë, përkatësisë politike, statusit shoqëror apo përkatësisë prindërore;

d) Nëse manifeston sjellje të cilat bien në kundërshtim me Kodin e Etikës.

29. Kandidatët që rezultojnë fitues në fazat e tjera të testimeve, i nënshtrohen intervistës së strukturuar me gojë. Pyetjet synojnë të testojnë aftësitë e kandidatit për të komunikuar qartë, për të shprehur ide dhe koncepte, si dhe për të analizuar dhe marrë vendime.

30. Para fillimit të intervistës bëhet sistemimi i ambienteve, ku zhvillohet intervista dhe zhvillohet procedura e mëposhtme:

a) Grupi i regjistrimit bën regjistrimin e kandidatëve që paraqiten për intervistë;

b) Kandidati në momentin e regjistrimit duhet të paraqesë kartën e identitetit;

c) Pyetjet hartohen nga Komisioni i Përhershëm i Testimit dhe nuk i kërkojnë njohuri paraprake të teknikave të policisë, por përqendrohen në aftësinë e kandidatit për të komunikuar qartë, për të shprehur ide dhe koncepte, si dhe për të analizuar dhe vendosur;

d) Rezultati nga anëtarët e Komisionit vendoset në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri dhe në fund përcaktohet mesatarja e pikëve.

31. Vlerësimi i intervistës nga Komisioni, përbën 50% të rezultatit të përgjithshëm të kandidatit.

32. Rezultati i përgjithshëm i kandidatit përcaktohet mbi bazën e rezultateve të arritura nga testimi me shkrim dhe intervista me gojë. Kandidatët renditen në listën përfundimtare, sipas rezultateve të arritura.

33. Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Sektori i Teknologjisë dhe Informacionit, shpallin publikisht listën, jo më vonë se të nesërmen e ditës së përfundimit të procesit të vlerësimit të intervistimit me gojë.

34. Kandidatët të cilët kalojnë me sukses procesin e testimit, përfshihen në listën e kandidatëve për t'u pranuar në Policinë e Burgjeve në vendet e lira, sipas pikëve të marra në procesin e testimit në rend zbritës. Në rastet kur dy ose më shumë kandidatë rezultojnë me pikë të barabarta, atëherë renditja e tyre bëhet nëpërmjet shortit.

35. Lista e kandidatëve të përzgjedhur është e vlefshme për një vit, duke filluar nga data e përfundimit të procesit të pranimit.

36. Për vendet e tjera të lira që krijohen brenda një viti, pranimi bëhet nga kandidatët e tjerë që renditen në listën e fituesve.

37. Drejtori i Policisë së Burgjeve nxjerr urdhrin për fillimin e trajnimit bazë të Policisë së Burgjeve.

38. Dokumentacioni i punonjësit të pranuar në Policinë e Burgjeve, bashkë me certifikatën e trajnimit administrohet në një fashikull dhe i dërgohet zyrtarisht strukturës përkatëse ku emërohet punonjësi.

39. Dokumentacioni i kandidatëve që nuk rezultojnë fitues administrohet nga Sektori i Burimeve Njerëzore deri në momentin e fillimit të procedurës pasardhëse të pranimit dhe, më pas asgjësohen.

40. Pas përfundimit të trajnimit, punonjësi emërohet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe propozim të drejtorit të Policisë së Burgjeve.

41. Për punonjësin e emëruar lidhet kontrata njëvjeçare e periudhës së provës që nënshkruhet prej tij dhe drejtorit të Policisë së Burgjeve.

42. Në përfundim të periudhës së provës, mbi bazën e vlerësimit të punës nga eprori i drejtpërdrejtë, drejtori i Policisë së Burgjeve e konfirmon ose jo si punonjës të Policisë së Burgjeve.

43. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Ylli Manjani